

APD:

Një delegacion ekspertësh nga porti i Shangait, interesim për portin më të madh të vendit tonë

6 qershor 2018



Një delegacion me përfaqësues ekspertë nga sistemi portual i Shangait u prit pasditen e së martës nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i APD, Afrim Bakaj. Grupi i specialistëve kinezë që kryesohej nga prof. Ęang Zhan, Zv. President i Kongresit Popullor të Kinës dhe Drejtor Menaxhues i Akademisë së Shkencave Sociale të Shangait, u njoh me kapacitetet dhe funksionimin e portit më të madh të vendit tonë.

Drejtori Bakaj prezantoi rëndësinë strategjike të portit të Durrësit si një portë komunikimi mes Ballkanit dhe vendeve të Europës Perëndimore.

Drejtori Ekzekutiv i APD mirëpriti dëshirën e palës kineze për krijimin e marrëdhënieve dypalëshe mes porteve të Durrësit dhe Shangait, si dhe interesin për investime të mundshme në portin shqiptar.

Rritja e numrit të turistëve kinezë drejt vendit tonë; promovimi i produkteve bujqësore shqiptare dhe forcimi i marrëdhënieve dypalëshe ishin tema të tjera që u trajtuan në Takimin mes drejtorit Afrim Bakaj me specialistët nga Shanghai.

Takimi që zgjati mbi një orë u organizua në bashkëpunim me Ing. Spartak Nanon, shef i Marrëdhënieve me jashtë në Dhomën e Tregtisë Shqipëri-Kinë dhe zv. President i Konfindustrias shqiptare.

